



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BULQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

STRATEGJIA 2020 - 2027



Strategjia 2020 - 2027, është përgatitur nga Stafi i IADKsë me mbështetjen e donatorit Brot für die Welt (BfdW), me ekspertizën e ofruara nga znj Ursel Kroog dhe znj. Ariane Gruszczynski. Strategjia është shqyrtuar dhe aprovuar nga Bordi i Drejtoreve të IADKsë në Shtator 2020.

IADK është faleminderuese dhe mirnlohëse të gjithë atyre që kanë kontribuar në përpilimin dhe finalizimin e startegjisë.

EKIPI GJATË PËRGATITJES SË STRATEGJISË

ZENEL BUNJAKU
URSEL KROOG
ARIANE GRUSZCZYNSKI
ESMA KËPUZI
ARIANA PEĆI
ELHEME SHALA
MAGBULE HYSENI
HAFIZE VESELI SYLEJMANI
HANUMSHAHE ZENELI
SYLEJMAN BUNJAKU
NOVICA MARKOVIC
EGZON GËRXHALIU
FIDAN SKERAJ
ARBER HASANI
ARGJEND GJINOVCI

SHERIF MEHMETI
EGZONA HAJRA
ARTA IBRANI ZHUBI
BASRI PULAJ
ALBINA TAHIRI
HALIT GASHI
GËZIM MURSELI
EMA KURSHUMLIJA
EDITA MAHMUTI MULA
FJOLLA ZUÇAKU
LEART KAMBERI
BEHARE MLINAKU
BESARTA HAJRIZI
HASAN CENA
SHKURTE BUNJAKU



STRATEGJIA

2020 - 2027



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BULQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

AKRONIMET

IADK	Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës
Q-AAP	Qendra për Arsim dhe Aftësim Profesional
BE	Bashkimi European
LWF	Lutheran World Federation
BfdW	Brot für die Welt
OJQ	Organizatë joqeveritare
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MF	Ministria e Financave
AU	Agjensia e Ushqimit
FB	Fakulteti i Bujqësisë
AKK	Autoriteti Kombëtar për Kualifikim
AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
BPV	Bruto Produkti Vendor

PROFILI I IADK-ëS DHE STRATEGJIA E RE

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) është një organizatë joqeveritare, jofitimprurëse e themeluar në vitin 2004, dalur nga programi LWF. Për 15 vite që nga themelimi, organizata ka zbatuar mbi 125 projekte, me qëllim të avancimit të fermerëve të vegjël, të grave dhe të rinjëve në bujqësi. IADK vazhdon të fuqizohet, duke mësuar dhe duke u zhvilluar çdo herë. Ajo është njëra ndër akterët kryesor për zhvillimin e bujqësisë në Kosovë, njëherit organizata më e madhe në sektorin e bujqësisë, e cila ofron shërbime në këtë sektor. IADK gjithashtu ka bashkëpunim të ngushtë me institucionet relevante, ministrinë, politikbërësit dhe të gjithë ata të cilët kanë ekspertizë të lartë në sektorët përkatës.

Bujqësia është duke u rritur dhe ndryshuar, ajo vazhdon të rritet dhe të ndryshoj në mënyrë të konsiderueshme, kështu që duke u bazuar në këtë fakt, IADK do të eksploroj përmundësi dhe sfida të reja dhe si rezultat i kësaj do të përpilohet strategjia për periudhën 2020-2027.

Zhvillimi i strategjisë së re ishte në qasjen pjesëmarrëse, që do të thotë konsultimi dhe përfshirja e akterëve të ndryshëm, ekipi i IADK dhe me lehtësimin e konsulentit ndërkombëtar të mbështetur nga BfdW. Megjithëse strategjia e re do të formojë shtyllën kurriore të punës së IADK për vitet e ardhshme, është një instrument dinamik që do të rishikohet dhe përditësohet pëtë akomoduar ndryshimet në mjedisin institucional, ekonomik dhe fizik.

Strategjia e IADK-ës do të implementohet përmes projekteve, aktiviteteve dhe shërbimeve, sipas objektivave të caktuara, planeve të veprimit dhe buxhetit, të cilat janë dizajnuar sipas kornizës strategjike dhe kontribuojnë në realizimin e vizionit të organizatës.

VIZIONI

Vizioni ynë është zhvillimi i bujqësi moderne në zonat rurale, gjithëpërfshirja dhe krijimi i një mjedisit të qëndrueshëm në Kosovë. IADK përpinqet të krijojë një shoqëri paqësore dhe të drejtë, në të cilën të gjithë burrat dhe gratë përcaktojnë rrjedhën e jetës së tyre në dinjitet dhe siguri, ku të gjithë mund të marrin pjesë dhe të evoluojnë pa asnjë diskriminim në lidhje me fenë, përkatësinë etnike.

MISIONI

Misioni ynë është promovimi i zhvillimit socio-ekonomik të zonave rurale, ulja e papunësisë dhe krijimi i mundësive për gjenerim të të ardhurave për njerëzit që jetojnë në zona rurale. Ne kontribuojmë në uljen e migrimit nga zonat rurale në ato urbane dhe mbështesim fermerët dhe aktivitetet bujqësore, duke marrë parasysh barazinë gjinore, përfshirjen e të rinjve dhe minoriteteve, integrimin dhe përfshirjen e të riatdhesuarve, dhe rritjen e vetëdijesimit përmbrrojtjen e mjedisit.

QËLLIMI

Fermerët, gratë dhe të rinjtë rrisin të ardhurat dhe punësimin e tyre në bujqësi në zonat rurale dhe zonat e thella të Kosovës.

VLERAT DHE PARIMET E IADK-së

Puna e IADK-ës udhëhiqet me profesionalizëm dhe me punë ekipore, e cila demonstrohet nga një staf shumë i përkushtuar dhe i motivuar, si dhe transparenca, mos diskriminimi, barazia gjinore dhe përfshirja e të rinjve, grupeve minoritare dhe të marginalizuara.

Ne mbështesim, ndihmojmë dhe udhëzojmë fermerë të vegjël dhe të mesëm përmes promovimit të praktikave më të mira të shteteve evropiane, të cilat mundësojnë rritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimit.

IADK përpinqet të balancoj aspektin social, ekonomik, si dhe problemet mjedisore. IADK provon ide të reja dhe inovative, duke gjykuar se çfarë do të funksiononte në komunitetet rurale ose për grupe specifike. Ne mundohemi të jemi sa fleksibil, aq edhe të adaptueshëm drejt ndryshimeve dhe përmirësimeve në bujqësi.

KONTEKSTI I ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË NË KOSOVË

Ekonomia jonë është rritur vazhdimesht mbi mesatarën e shteteve të Balkanit Perëndimor gjatë periudhës së krizës financiare post-globale. Bujqësia në Kosovë është sektor shumë i rëndësishëm me një aktivitet të rëndësishëm ekonomik për vendin tonë, duke marrë pjesë me mbi 10% në BPV dhe i dyti pas tregtisë me shumicë dhe pakicë. Përtej konsideratës ekonomike, mbështetja e Kosovës në bujqësi është çështje sociale: aktiviteti bujqësor është i përhapur në Kosovë si një rrjet sigurie për shumicën e popullsisë.

Edhe pse ka një pjesëmarrje mjaft të lartë në BPV, bujqësia karakterizohet nga problemet strukturore që rezultojnë në efikasitet të ulët të punës dhe me kosto të lartë të prodhimit. Sidoqoftë, janë pak sektorë që vazhdojnë të kërkohen, për shkak të rëndësisë ekonomike dhe potencialit për zhvillim të mëtejshëm. Në këtë kontekst, qumështi / blegtoria, pemët dhe perimet janë sektorë që duhen konsideruar më tej.





Kosova aktualisht po përballet me një pabarazi të dukshme midis arsimimit të duhur dhe varfërisë. Mundësítë e punës janë shumë të kufizuara, më të dukshme në zonën rurale, duke rezultuar në migrim të lartë nga zona rurale në pjesët urbane të Kosovës. Kushtet e vështira të tregut të punës kanë qenë veçanërisht të rënda për të rinjtë, gratë dhe pakicat. Në këtë kontekst, bujqësia, posaçërisht kultivimi i pemeve, perimeve ose bimëve mjekësore dhe aromatike do t'i çojë ata drejt aktiviteteve ekonomike, pasi moti dhe kushtet e tokës janë të favorshme.

Hortikultura përbën rrith 50% të prodhimit të përgjithshëm, por Kosova është ende një importuese e madhe e frutave, perimeve dhe bimëve dekorative. Sidoqoftë, ka një potencial në rritje të zëvendësimit të importit me eksportin të frutave dhe perimeve në vendet fqinje bazuar në fuqinë punëtore të lirë dhe kushtet agroklimatike që favorizonjë prodhimin e një cilësie të lartë të frutave dhe perimeve. Perimet më të rëndësishme janë domatja, speci, trangulli dhe patatja, etj, pastaj frutat siç janë mollat, kumbullat, dredhëza etj. Prodhimi blegtoral shihet si një shtyllë kurriore e bujqësisë së Kosovës, e konsideruar si një aktivitet me një rëndësi të konsiderueshme sociale dhe ekonomike. Përveç sektorëve të përmendur më lart, përpunimi i frutave, perimeve dhe qumështit mbetet shumë i rëndësishëm për gjenerimin e të ardhurave dhe përfshirjen e grave në punësim.

Pavarësisht nga potenciali që ekziston, bujqësia vazhdon të karakterizohet nga kufizime të tillë si fragmentimi i tokës, duke i bërë shumicën e fermave të vogla midis madhësive prej 0.5 deri në 2.0 ha.

Niveli i trajnimit profesional në bujqësi është ende duke provuar për të ofruar trajnim me cilësi të lartë. Një çështje e tillë ka kufizuar mundësítë e punësimit, duke e bërë të vështirë për të rinjtë të kenë qasje në punën e tyre të dëshiruar. Për më tepër, për shkak të mungesës së programeve bujqësore në nivelin e arsimit/trajnimit, grapi i të rinjve nuk trajtohet si duhet,

autoritetet lokale dhe kombëtare nuk po ofrojnë mundësi bujqësie brenda programeve të tyre (qasja në grante) për përfshirjen e të rinjve në bujqësi. Prandaj, të rinjtë e diplomuar nuk janë të pajisur mirë me aftësi dhe si të tillë ata nuk janë të përgatitur për tregun e punës.

Zakonisht, fermerët nuk janë të organizuar dhe ata veprojnë me pak ekspertizë teknike, përdorim të dobët të inputeve moderne dhe qasje të kufizuar në kredi për investime dhe rritje. Shumica e fermerëve, komuniteti që jeton në zonat e thella rurale kanë qasje të kufizuar në shërbimet këshillimore, përdorin teknologji dhe praktika të vjetëruara të menaxhimit të fermave bujqësore.

Për më tepër, prodhimi bujqësor sfidohet nga ndryshimet mjedisore dhe klimatike, degradimi i tokës është një prej tyre, por gjithashtu teknologjia dhe shërbimet joadekuate mund të kenë ndikim më të lartë në ndryshimet klimatike.

Gratë janë një target grup jo i favorizuar, ku masat afirmative nga programet ndërkombe të që u jepen grave, keqpërdorohen nga të afërmit e tyre. Gjithashtu normat shoqërore që ekzistojnë në zonat rurale janë një faktor limitues dhe veprojnë si barrierë ndaj përfshirjes ekonomike dhe shoqërore të grave. Veç kësaj, të drejtat e pronës, marrja e vendimeve dhe përfshirja shoqërore në zhvillimin bujqësor, vështirësojnë formësimin dhe përfshirjen e grave në ekonominë e bujqësisë dhe aktivitete rurale.

Duke marrë parasysh disa nga kufizimet, sfidat dhe potencialet e përmendura më lartë, organizata parashët t'i zgjidh ato përmes strategjive dhe intervenimeve të ndryshme në vitet e ardhshme. Si i tillë plani strategjik i tetë viteve të ardhshme do të jetë një material i mirë për t'i zgjidhur kufizimet dhe do të intervenojë në një mënyrë më strategjike dhe të qëndrueshme.



ME KË PUNOJMË NE

• Komunitetet - fermerët

Ne punojmë me komunitete, persona të interesuar që kujdesen për interesat e tyre, të cilët/cilat synojnë të gjenerojnë të hyra dhe u ofrojmë mundësi punësimi përmes aktiviteteve bujqësore.

- Target grupi vjen nga zona të thella rurale (fermerët), ata të cilët kanë nivele të ulëta të të ardhurave dhe janë në një situate të keqe ekonomike;
- Target grupi përfshinë të rinjtë dhe studentët nga fakultetet bujqësore dhe të prodhimit të ushqimit, dhe të sapodiplomuarit;
- Target grupi përfshinë femra, grupe të marginalizuara dhe minoritete në zona rurale, të papunësuarit dhe ata/ato që jetojnë në kushte të vështira ekonomike.

Megjithatë IADK mund të punojë edhe me grupe të tjera gjatë gjithë implementimit të strategjisë.

• PËRKRAHËSIT VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR

Numri i përkrahësve të IADK-së është në rritje, çka dhe mundëson operimin e suksesshëm dhe mbështetjen e komunitetit në nevojë. Çdo vit ne rritemi përkrahë rrethit të donatorëve ndërkombëtar, kryesisht nga vendet e BE-së, por edhe bizneseve lokale dhe individëve.

• Partnerët vendor dhe nderkombëtar

Ne punojmë me një grup të partnerëve ndërkombëtar dhe lokal, puna e të cilëve është e ngjashme me tonën, përvoja, aftësitetë dhe investimi i të cilëve na ndihmon në punën tonë. Në nivelin lokal, ne punojmë me komuna, departamente përkatëse, specifisht me atë bujqësor, të zhvillimit ekonomik dhe gjinor, organizata të fermerëve dhe OJQ.

Në nivelin qendror ne punojmë me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Agjencinë e Ushqimit (AU), Fakultetin e Bujqësisë dhe Autoritetin Kombëtar për Kualifikim (AKpK), etj. Por ndikimi i tyre në fushën e zhvillimit ekonomik mund të mos jetë e ngjashme me secilin partner.

KU PUNOJMË NE – HAPËSIRA GJEOGRAFIKE

Zyra kryesore dhe Qendra për Arsim dhe Aftësim Profesional (Q-AAP) është në Vushtrri, ku ne punojmë me një rreth të gjerë të komuniteteve, shumica e të cilëve janë të vendosur në zonat rurale në të gjitha pjesët e Kosovës.

AVANTAZHI KRAHASUES DHE PRITSHMËRITË E PALËVE TË INTERESIT


Që nga themelimi i saj, IADK-ja ka shërbyer si model i një organizate të angazhuar dhe transparente. Kjo ka shpjer në rritjen e numrit të partnerëve dhe përfituesve, duke e zmadhuar horizontin e punës dhe numrin e stafit profesional. IADK-ja njihet si një organizatë bujqësore profesionale dhe e besueshme, që punon ngshtë me klientët e saj, palët e interesit, partnerët dhe organizatat donatore.

Palët e interesit dhe partnerët presin që IADK të veproj si:

- një organizatë që e zhvillon bujqësinë duke sjellë teknika të reja bujqësore, të cilat përshtaten me ofertën dhe kërkesën për furnizim;
- një organizatë profesionale ku fermerët pa dallim gjinnie, moshë dhe etnie, mund të fitojnë informacione mbi problemet bujqësore;
- një organizatë e informuar mbi trendet e reja të zhvillimit bujqësorë, dhe transmetimin e tyre te fermerët;
- një kontribuuves i rëndësishëm në përgatitjen dhe implementimin e ligjeve dhe strategjive;
- një organizatë që ofron shërbime këshilluese, AAP për fermerët;
- promovimi dhe zbatimi i praktikës dhe sigurisë në punën si formë e përgatitjes profesionale;
- një partner i besueshëm lokal për implementimin e projektit në agjencitë ndërkombëtare, që i financon rastet e përshtatshme dhe nuk ndikohet nga çështjet politike dhe interesat personale.



Teoria e Ndryshimit



Strategjia	Zhvillimi i institucionali i ADK-së	Inovacioni në Bujqësi	Avtoriteti i Lëshimit	Organizatat e femerive	Zhvillimi i institucionali i ADK-së
Mësimet në Bulqësi, Shërbimet, Grantet Materiale Dështjet	<ul style="list-style-type: none"> Trajnim i teknike për femerat e një sektor (blegjet & hortikulturë) dhe teknika moderne profesionale. Arsimi dhe Atësimi Professional (AAP) për femerat që kanë përfunduar shkollimin e mesëm, (mëli II). Kashila i është ofrijedhet e mendimtore monitorezimi per femerat e një sektor. Grante i është mira materiale që përgjigjet e mendojnë jo shtëpi. Trajime për përdorimin e mjetave që sigurojnë punë për femerat. 	<ul style="list-style-type: none"> Nxitja e vërtetës gjorje për pronovimin e tij të inovave në bujqësi Mështetja e njëve përmes (blegjet & hortikulturë) dhe teknika moderne profesionale. Gratë, Të Rinjtë dhe Minoritetet 	<ul style="list-style-type: none"> • Trajnimi për femerat për teknologji të reja • Trajnimi i fermerëve spesializuar për çështjet e BE-së • Lehtësimi i procesit të certifikimit për femerat • Lehtësimi i përdorimit të intensitetit për marrjen e akreditimit • Mështetja e organizmit shkollor të mësuar praktikës së mësuarit • Grane - i është mështetja e një organzioni shkollor që përgjigjet e përdorimit të teknologjisë së mësuarit • Mështetja e njëve përmes (blegjet & hortikulturë) dhe teknika moderne profesionale • Mështetja e njëve përmes (blegjet & hortikulturë) dhe teknika moderne profesionale 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxitja e komunitetit për zhvillim strategjic i lyre për bujqësi siç është duke përfshirë shpërndarje e grantave • Ofoni informacione, trajnimin e mbështetjeje përmes adaptivës së femerave • Ofoni vizita shkollorëse për femerat që kanë përfunduar shkollimin e mesëm • Mështetja e njëve përmes (blegjet & hortikulturë) dhe teknika moderne profesionale • Identifikimi i mënyrave përgatitjeve e kësaj kohë të caktuar • Lohni te Qeveria, që t'ë gjithë përfusojte e granteve të kësia trajnim profesional (AAP) • Rri intensitetin e rumbuklaveve, lejë mështetjeje së përgatitjeve e femerave • Informacioni dhe llohim i drejtardjetës së femerave përkohës së mësuarit • Trajnimi i teknikës së teknologjisë së mësuarit • Mështetja e njëve përmes (blegjet & hortikulturë) dhe teknika moderne profesionale • Mështetja e njëve përmes (blegjet & hortikulturë) dhe teknika moderne profesionale 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja e njëve përmes (blegjet & hortikulturë) dhe teknika moderne profesionale • Mbështetja e njëve përmes (blegjet & hortikulturë) dhe teknika moderne profesionale • Mbështetja e njëve përmes (blegjet & hortikulturë) dhe teknika moderne profesionale • Mbështetja e njëve përmes (blegjet & hortikulturë) dhe teknika moderne profesionale • Mbështetja e njëve përmes (blegjet & hortikulturë) dhe teknika moderne profesionale • Mbështetja e njëve përmes (blegjet & hortikulturë) dhe teknika moderne profesionale • Mbështetja e njëve përmes (blegjet & hortikulturë) dhe teknika moderne profesionale • Mbështetja e njëve përmes (blegjet & hortikulturë) dhe teknika moderne profesionale • Mbështetja e njëve përmes (blegjet & hortikulturë) dhe teknika moderne profesionale
Aktivitetet					

QASJA STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT E PROGRAMIT

STRATEGJIA: Mësimet në Bujqësi, Shërbimet, Grantet - Materiale në të mira dhe Pajisjet

OBJEKTIVI 1: Fermerët ngrisin cilësinë dhe sasinë e prodhimit si dhe të ardhurat nga shitjet e prodhimit.

Ngritura e kapaciteteve prodhuese të fermerëve, gjenerimi i sigurt i të ardhurave nga shitja e prodhimeve cilësore dhe në sasin e kërkuar nga tregu”.

REZULTATET

Me këtë program ne kemi për qëllim të arrijmë këto rezultate:

- Fermerët rrisin sasinë dhe cilësinë e prodhimeve bujqësore;
- Fermerët prodhojnë produkte të standardizuara;
- Fermerët rrisin shitjet e tyre në treg;
- Fermerët kanë produkte të brenduar;
- Fermerët kanë një treg të përbashkët dhe furnizim të qëndrueshëm të produktit;
- Fermerët mbajnë shënime për prodhimin dhe marketingun.

STRATEGJIA: Trajnimë profesionale në bujqësi, trajnimi dhe këshillimi i drejtpërdrejt, si dhe grantet – në të mira materiale dhe mbështetja me pajisje mbetet një strategji thelbësore për të rritur cilësinë dhe sasinë e prodhimit. Trajnimi do të jetë i përshtatshëm për sektorët e bujqësisë dhe nevojat specifike të grupeve të synuara dhe do të përfshijë trajnime për qasje në treg.

Programi do të ndërmarrë disa aktivitete:

- Trajnime teknike për fermerët e një sektori premtues (blegtori dhe hortikulturë) dhe teknika moderne profesionale;
- Arsimi dhe aftësimi profesional (AAP) për fermerë (që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm, niveli III);
- Këshilla të drejtpërdrejta, mentorim dhe monitorim për fermerë;
- Grante në të mira materiale dhe pajisje për fermerët, që ta modernizojnë mënyrën e prodhimit;
- Trajnime për përdorimin e mjeteve dhe sigurinë në punë për fermerë;
- Trajnimi për mbajtje të shënimeve (kontabilitet) dhe hyrjen në treg.

STRATEGJIA: Zhvillimi gjithëpërfshirës, adresimi i grupeve të veçanta të synuara: Gratë, të rinjtë dhe minoritetet

Zhvillimi gjithëpërfshirës kërkon qasje specifike për të dhënë ndryshime të barabarta për ata që janë të marginalizuar në mënyra të veçanta; prandaj IADK ka hartuar strategji specifike për të inkurajuar pjesëmarrjen e grave dhe të rinjve në bujqësi, duke marrë parasysh kufizimet e tyre specifike. IADK përpinqet të përfshijë pakicat në të gjitha strategjitë.

OBJEKTIVI 2: Gratë angazhohen në bujqësi për krijimin e të ardhurave dhe fuqizohen.

REZULTATET

Me këtë program ne kemi për qëllim të arrijmë këto rezultate:

- a) Gratë marrin vendime të angazhohen në aktivitete ekonomike;
- b) Gratë krijojnë biznese dhe prodhojnë produkte shtëpiake në mënyre profesionale
- c) Gratë bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe organizohen për të çuar më tej interesat e tyre;
- d) Gratë mësojnë nga të tjerët që të zhvillojnë produkte të reja;
- e) Gratë gjenerojnë të ardhura.

STRATEGJIA: Normat sociale që pengojnë pjesëmarrjen ekonomike të grave dhe mungesën e besimit të grave dhe sfidat kryesore për tu kapërcyer. Pjesëmarrja dhe suksesi ekonomik krijon besim dhe fuqizim të grave përtëj aspekteve ekonomike. Programi ofron trajnime të posaçme profesionale dhe grante në të mira materiale dhe pajisje për gratë, promovon bashkëpunim dhe shkëmbim midis grave dhe rritë vetëdijken gjinore dhe avokimin për të rritur pranimin e komunitetit për angazhimin ekonomik të grave.

Programi do të ndërmarrë disa aktivitete:

- Ngritura e vetëdijes për përfshirjen e grave në komunitet, ndërgjegjësimi për të drejtat e pronës;
- Arsim dhe Aftësim Profesional (AAP) për gratë në përpunimin e ushqimit dhe zhvillimin e produktit;
- Dhënia e granteve dhe mjeteve të përshtatshme për bizneset fillestare për gratë;
- Mbështetja e grave për të marr pjesë në vizita studimore në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.

OBJEKTIVI 3: Një numër në rritje i të rinjve angazhohen në bujqësi

REZULTATET

Me këtë program ne kemi për qëllim t'i arrijmë këto rezultate:

- Të rinjtë angazhohen në prodhim bujqësor për konsum dhe marketing;
- Të rinjtë fillojnë bizneset në bujqësi dhe rrisin të ardhurat;
- Studentët në bujqësi gjejnë punësim, mundësitë për punësim rriten;
- Studentët në bujqësi rrisin kapacitet dhe eksperiencën e tyre

STRATEGJIA: Shumë pak të rinj e shohin bujqësinë si një mundësi për veten e tyre. Programi promovon ngritjen e vetëdijes, ekspozimet dhe mësimin e kolegëve për të rritur dhe ruajtur interesin e tyre përveç trajnimit profesional, në grante dhe mbështetje me pajisje për ide të reja biznesi.

Programi do të ndërmarrë disa aktivitete:

- Ngritura e vetëdijes për promovimin e të rinjve në bujqësi;
- Mbështetja e të rinjve për të marrë pjesë në fermë, inkurajimin dhe motivimin e tyre përfitimet që vijnë nga bujqësia;
- Mbështetja dhe organizimi i vizitave shkëmbyese për të këmbyer eksperienca;
- Trajnimet të përkohshme dhe teknike për të rinjtë në bujqësi;
- Mbështetja e të rinjve përmes granteve në të mira materiale (ide inovative) dhe pajisje për biznese fillestare;
- Ofrimi i praktikave për studentët e bujqësisë dhe lidhja e tyre me tregun e punës.

STRATEGJIA: Inovacion në Bujqësi

OBJEKTIVI 4: Fermerët adaptojnë prodhimin për të rritur konkurrencën dhe për të hyrë në tregje të reja

REZULTATET

Përmes këtij programi ne kemi për qëllim t'i arrijmë rezultatet e mëposhtme:

- Fermerët prodhojnë me standarde më të larta për të qenë konkurrent në tregun regional;
- Fermerët prodhojnë sipas standardeve të BE-së;

- c) Fermerët aplikojnë teknologji të reja dhe zvogëlojnë shpenzimet ose rrisin efikasitetin dhe eficiencën e prodhimit;
- d) Fermerët prodhojnë dhe shesin produkte të certifikuara (duke përfshirë ato organike);
- e) Shembujve për mundësi të reja (inkubatorët rural) janë inicuar;

STRATEGJIA: Programi ofron mbështetje për fermerët për të prodhuar sipas standardeve më të larta dhe për të zhvilluar mundësi të reja produktesh për të rritur konkurrencën dhe qasjen në treg.

Programi do të ndërmarrë disa aktivitete:

- Trajnim i fermerëve për teknologji të reja;
- Trajnim i fermerëve sipas kritereve për çasje në tregje të BE-së;
- Lehtësimi i procesit të certifikimit për fermerët;
- Lehtësimi i palëve relevante të interesit për marrjen e akreditimit;
- Informacion dhe ndihmë drejtpërdrejt të fermerëve për akreditim;
- Ofrimi i ideve të reja për zhvillimin e opsiioneve rurale përveç bujqësisë;
- Lehtësimi i inkubatorëve rural për ide të reja biznesi;

OBJEKTIVI 5: Fermerët përshtatin prodhimin sipas ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe ruajtjen e ambientit

REZULTATET

Përmes këtij programi ne kemi për qëllim t'i arrijmë rezultatet e mëposhtme:

- a) Fermerët adaptojnë mënyra të reja të kultivimit për të përballuar ndikimet e ndryshimit klimatik (moti ekstrem, më pak shi);
- b) Fermerët aplikojnë përdorimin racional të inputeve bujqësore dhe burimeve natyrore për të zvogëluar ndotjen;
- c) Fermerët përdorin kontejnerët për menaxhimin e mbeturinave bujqësore;
- d) Qeveria rishikon zbatimin e rregulloreve mjedisore (për administrimin e mbeturinave, ndotjen) - përgjigjet fermeri.

STRATEGJIA: Ndryshimi i kushteve klimatike kërkon praktika të reja dhe përdorim më të kujdeshëm të burimeve natyrore dhe respektimin e standardeve mjedisore.

Programi hulumton dhe siguron informacion dhe trajnim mbi kushtet e ndryshimit klimatik dhe masave adaptive, përdorimin racional të burimeve natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit, si dhe menaxhimin e mbeturinave bujqësore. Ajo hulumton ide të reja për produkte të sigurta përmjedisin.

Programi do të marrë disa aktivitete:

- Identifikon mënyra përtu marrë me ndryshimin e kushteve të motit;
- Ofron informacion, trajnime dhe mbështetje përmasat adaptive për fermerët;
- Ofron vizita shkëmbyese për fermerët përtë mësuar praktika të mira;
- Rrit ndërgjegjësimin dhe avokimin për ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Promovimi i përdorimit racional të burimeve natyrore dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Promovimi i agroturizimit dhe turizmit rural në zonë me potencial për zhvillim të mëtutjeshëm;
- Trajnimi i fermerëve përmenaxhimin e mbeturinave bujqësore;
- Rritja e njohurive të palëve të interesit përmbrojtjen e mjedisit.

STRATEGJIA: Avokim dhe Lobim

OBJEKTIVI 6: Politikat dhe programet qeveritare ofrojnë kushte më të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe fermerëve të vegjël

REZULTATET

Përmes këtij programi ne kemi për qëllim t'i arrijmë rezultatet e mëposhtme:

- a) Komunat kanë një strategji për zhvillimin e bujqësisë që lejon qasje efektive;
- b) Më shumë grante dhe shërbime përfitoohen nga fermerët e vegjël. Grante ofrohen vetëm për fermerët e trajnuar në bujqësi;
- c) Qeveria krijon një program të veçantë përtë ndihmuar fermerët e vegjël;
- d) Prodhucesit bujqësorë janë të liruar nga taksat;
- e) Ligji bujqësor implementohet në relacion me inpute bujqësore dhe informacionet mbi përbajtjen e produkteve ushqimore janë të domosdoshme;
- f) Fermerët dhe agro-përpunuesit janë përfshirë në ligjin e ri të punës.

STRATEGJIA: programet funksionojnë së bashku me autoritetet lokale dhe kombëtare për një qasje praktike drejt zhvillimit të bujqësisë dhe mbështetje për fermerët e vegjël, në nivelin e strategjive komunale për zhvillimin e bujqësisë, si dhe ligjeve dhe rregulloreve kombëtare që mbështesin fermerët dhe marketingun e produkteve bujqësore.

Programi do të marrë disa aktivitete:

- Mbështetja në nivelin komunal dhe lokal për zhvillimin e strategjive bujqësore dhe të zhvillimit rural, duke e përfshirë shpërndarjen e granteve për fermerët e vegjël;
- Ndihma për fermerët e vegjël në përgatitjen e aplikacioneve për grante në mënyrën e duhur dhe kohën e caktuar;
- Lobimi ndaj qeverisë që të gjithë përfituesit e granteve të kenë trajnim profesional (AAP);
- Dhënia e ekspertizës për qeverinë dhe përfaqësimi i interesave të fermerëve të vegjël në përgatitjen e ligjeve dhe masave që i prekin ata;
- Avokimi për implementimin e ligjit për bujqësi;
- Lobimi ndaj Ministrisë së Financave që prodhuesit agrar të lironen nga taksa;
- Lobimi për implementimin e rregullave mjedisore;
- Lobimi ndaj MPMS për ligjin e punës, në mënyrë që fermerët të përfshihen në të;
- Inicimi i vënieς së një bordi të ekspertëve, si mbikëqyrës, për bujqësi dhe për të këshilluar qeverinë;
- Udhëheqjen e dialogëve me palët e interesit, për të mbështetur agjendat e avokimit.

STRATEGJIA: Organizatat e fermerëve

OBJEKTIVI 7: Fermerët janë të organizuar për të përfaqësuar interesat e tyre

REZULTATET

Përmes këtyj programi ne kemi për qëllim t'i arrijmë rezultatet e mëposhtme:

- a) Organizatat e fermerëve do të kenë një zë dhe do t'i prezantojnë interesat e tyre në nivelin lokal dhe kombëtar;
- b) Fermerët themelojnë organizatën e tyre, e cila do të jetë funksionale për avokim dhe arritjen e interesave të tyre;
- c) Kooperativat bujqësore bashkëpunojnë me sukses dhe kontribuojnë në zhvillimin ekonomik.

STRATEGJIA: Programi do të hulumtojë mënyra efektive për të forcuar vetorganizimin e qëndrueshëm të fermerëve, të rrisë ndërgjegjësimin dhe të sigurojë mundësi që fermerët të shprehin interesa dhe të mbështesin fermerët aktivë dhe organizatat e grave sipas kërkesës.

Programi do të marrë disa aktivitete:

- Mbështetje për organizatat e zgjedhura të fermerëve dhe grave sipas kërkesës së tyre;
- Identifikimi i mënyrave efektive për të mbështetur vetorganizimin e fermerëve dhe grave;
- Lehtësoni tryezat e rrumbullakëta; të rritet ndërgjegjësimi për rëndësinë e shprehjes së interesave;
- Mbështet kooperativat bujqësore.

STRATEGJIA: Zhvillimi institucional i IADK-së

OBJEKTIVI 8: IADK rrit kapacitetet dhe njohjen për zhvillimin efektiv të bujqësisë për fermerët e vegjël në mënyra inovative

REZULTATET

Përmes këtij programi ne kemi për qëllim t'i arrijmë rezultatet e mëposhtme:

- a) Stafi dhe organizata e IADK-së posedojnë kapacitete për zbatimin e strategjive efektive;
- b) Monitorimi dhe evoluimi që mbështetë mësimin përmes praktikës individuale, përshtatjen e menaxhmentit, rezultatet e dukshme dhe ndikimi i punës;
- c) Sistemi monitorues është i integruar dhe mirëmbahet nga IADK, stafi zotron aftësi të duhura.

STRATEGJIA: Strategjia e IADK kërkon që personeli me aftësi të çojë drejt inovacionit dhe efektivitetit. Menaxhimi i stafit dhe zhvillimi i kapaciteteve do të hartohen në përputhje me rrethanat. Krijimi i një sistemi të monitorimit që mundëson mësimin e brendshëm dhe menaxhimin adaptues për shikueshmërinë e arritjeve, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm, është një strategji tjeter kryesore.

Programi do të ndërmarrë disa aktivitete:

- Ofron ngritjen e kapaciteteve të stafit për qasje të reja për të përballuar ndryshimet në bujqësi, p.sh.: teknika inovative të bujqësisë, marketing, përshtatje për ndryshimet klimatike, qasje në lobim dhe avokim, mbështetje në organizimin e fermerëve;
- Shkëmbohen vizita për të marrë përvojë dhe mësojnë nga vendet e rajonit dhe ato ndërkombëtare;
- Vendosja e sistemit të monitorimit për programin e ri të zhvillimit, dixhitalizimin;

OBJEKTI 9: IADK siguron qëndrueshmëri financiare përmes burimeve të ndryshme të të hyrave

REZULTATET

Përmes këtij programi ne kemi për qëllim t'i arrijmë rezultatet e mëposhtme:

- a) IADK rrit të hyrat nga ofrimi i shërbimeve, arsimi dhe aftësimi profesional (AAP);
- b) IADK validohet në sektorë të rinj dhe nën sektorët të AAP;
- c) IADK krijon një qendër moderne të trajnimit – aftësimit profesional për agro-përpunim.

STRATEGJIA: IADK synon të zgjerojë funksionin në mënyrë të qëndrueshme si një ofrues trajnimësh me një strategji kryesore për të rritur të ardhurat e veta dhe në këtë mënyrë qëndrueshmërinë financiare për operim sa më të lehtë në baza ditore në përballimin e kostove të ndryshme që paraqiten.

Programi do të ndërmarrë disa aktivitete:

- Certifikimi i agronomëve dhe (re) licencencimi për shërbime këshillimore në bujqësi;
- Zhvillon skema të përshtatshme për shkëmbim të përvojave të studentëve për gjenerimin e të ardhurave;
- Të lobjoj në nivel qendror dhe lokal të qeverisjes, për prodhuesit dhe organizatat e fermerëve për të kontraktuar IADK-në, në ofrimin e trajnimeve dhe arsimim dhe aftësim profesional (AAP);
- Hartimi i kurrikulës për sektorë dhe nënsektorë të rinj sipas AKK-së;
- Identifikimi i mënyrave për të rritur qëndrueshmërin financiare nga projektet e finançuar nga partnerët dhe donatorët.

PËRMBAJTJA

PROFILI I IADK-ËS DHE STRATEGJIA E RE.....	5
VIZIONI.....	6
MISIONI.....	6
QËLLIMI.....	6
VLERAT DHE PARIMET E IADK-SË.....	7
KONTEKSTI I ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË NË KOSOVË.....	7
ME KË PUNOJMË NE.....	10
KU PUNOJMË NE – HAPËSIRA GJEOGRAFIKE.....	11
AVANTAZHI KRAHASUES DHE PRITSHMËRITË E PALËVE TË INTERESIT.....	11
TEORIA E NDRYSHIMIT	12
QASJA STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT E PROGRAMIT.....	14



Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!



Adresa: Sfaraçak i Ulët, Nr.11
42,000 Vushtrri, Kosovë

E-mail: info@iadk.org
Tel: +383 (0) 44 777 036
+383 (0) 49 777 046
Web: www.iadk.org